



REPUBLIKA E KOSOVËS
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Gjykata Kushtetuese / Ustavni sud / Constitutional Court

Prishtina, 15 tetor 2010
Ref. Nr.: RK 51 /10

VENDIM MBI PAPRANUESHMËRINË

në

Rastin Nr. KI 26/09

z. Ekrem Gashi

kundër

Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës¹

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

E përbërë nga

Enver Hasani, Kryetar
Kadri Kryeziu, Zëvendëskryetar
Robert Carolan, Gjyqtar
Altay Suroy, Gjyqtar
Almiro Rodrigues, Gjyqtar
Snezhana Botusharova, Gjyqtar
Ivan Čukalović, Gjyqtar
Gjyljeta Mushkolaj, Gjyqtar dhe
Iliriana Islami, Gjyqtar

Parashtruesi i kërkesës

1. Parashtruesi i kërkesës është Z. Ekrem Gashi, me vendbanim në Prishtinë.

Pala kundërshtarë

2. Palë përgjegjëse është Banka Qendrore e Republikës së Kosovës (më tutje: "Banka Qendrore") si pasardhës juridik i Autoritetit Qendror Bankar dhe të Pagesave të Kosovës (më tutje "AQBK"), i cili ka qenë punëdhënësi i parashtruesit të kërkesës në kohën kur kanë ndodhur ngjarjet.

Kopje e vërtetuar
Overena kopia
Certified Copy

¹ Në kohën e ngjarjeve, paraardhësi i tij ka qenë Autoriteti Qendror Bankar dhe i Pagesave të Kosovës (AQBK).

Objekti i çështjes

3. Parashtruesi i kërkesës ankohet se AQBK-ja e shkarkoi atë në kundërshtim me ligjin në fuqi në Kosovë e cila nuk i është përmbajtur vendimeve të gjykatës për kthimin e tij në vendin e punës. Ai thirret në shkëlqen e neneve 49 dhe 54 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (më tutje: "Kushtetuta").

Baza juridike

4. Neni 113 (7) i Kushtetutës, Nenet 20 dhe 22 (7) dhe (8) të Ligjit (Nr. 03/L-121) për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës e 16 dhjetorit 2008 , (më tutje: "Ligji") dhe Neni 54 (b) i Rregullores së Punës të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (më tutje: "Rregullorja").

Procedurat para gjykatës

5. Kërkesa është regjistruar më 9 korrik 2009 dhe i është kumtuar AQBK-së për komente.
6. Më 22 janar 2010, AQBK ka parashtruar përgjigje pranë kësaj Gjykate.
7. Më 15 qershor 2010, Kolegji Shqyrtues i përbërë nga Gjyqtarët Kadri Kryeziu (Kryesues), Enver Hasani dhe Iliriana Islami shqyrtuan raportin e Gjyqtarit Raportues Robert Carolan, dhe i rekomanduan Gjykatës lidhur me pranueshmërinë e Kërkesës.

Faktet

8. Parashtruesi i kërkesës ka punuar si vozitës për AQBK-në në pajtim me kontratën e punësimit e lidhur ndërmjet palëve më 1 shkurt 2001.
9. Më 19 mars 2002, AQBK ka përfunduar marrëdhënien e punës së parashtruesit të kërkesës, siç pohohet për sjellje të këqija.
10. Më 26 janar 2005, parashtruesi i kërkesës ka parashtruar padi pranë Gjykatës Komunale të Prishtinës duke kundërshtuar vendimin për pushim nga puna. Gjykata Komunale kishte gjetur se ndërprerja e kontratës së punësimit të parashtruesit të kërkesës nga ana e punëdhënësit nuk ishte bërë në pajtim me ligjin në fuqi në Kosovë dhe së këndejmi kishte anuluar vendimin për pushim nga puna. Krahas kësaj, Gjykata Komunale i kishte urdhëruar AQBK-së që t'a kthejë parashtruesin e kërkesës në vendin e punës dhe t'a kompensojë atë për shpenzimet e padisë në shumën prej 639.60 EUR.
11. Gjykata Komunale kishte gjetur se punëdhënësi kishte shkelur nenin 11 (5) të Rregullores së UNMIK-ut (2001/27) mbi ligjin themelor të punës, (më tutje "Rregullorja e UNMIK-ut 2001/27")²² dhe përfundoi se punëdhënësi nuk ka rishikuar

²² Neni 11 (5) parasheh që "...nëse marrëdhënia e punës ndërprehet nga punëdhënësi në baza të kësaj sjelljeje së rëndë, atëherë punëdhënësi duhet:

- "të njoftojë të punësuarin me shkrim se ka për qëllim të ndërprejë marrëdhënien e punës. Njoftimi i tillë përfshin bazat për ndërprerje; dhe"
- "takimi do të mbahet ndërmjet punëdhënësit dhe të punësuarit dhe në të takimin e tillë punëdhënësi i kumton të punësuarit sqarimin gojor për bazat e ndërprerjes së punës dhe nëse i punësuarit është anëtar i sindikatës atëherë ai ka të drejtë që në atë takim të jetë i pranishëm edhe përfaqësuesi i sindikatës."

Neni 49 parasheh:

vendimin për ndërprerje të marrëdhënies së punës siç është kërkuar nga ana e punëdhënësit, për shkak se në pajtim me nenin 178 (2) të ligjit të përbashkët të punës, punëdhënësi është dashur të shtyjë ndërprerjen e marrëdhënies së punës kur parashtruesi i kërkesës ka kërkuar rishikimin e vendimit. Sipas pikëpamjes së gjykatës komunale, ligji i përbashkët i punës ka qenë ligji në fuqi në Kosovë në pajtim me rregulloren e UNMIK-ut 1999/24 për ligjin në fuqi në Kosovë (më tutje "Rregullorja e UNMIK-ut 1999/24") siç është ndryshuar me Rregulloren e UNMIK-ut (2000/59).

12. Më 10 qershor Gjykata e Qarkut në Prishtinë vërtetoi vendimin dhe arsyetimin juridik të Gjykatës Komunale në Prishtinë dhe refuzoi ankesën e AQBK-së. Gjykata Kushtetuese gjeti se kontrata e punësimit e parashtruesit të kërkesës është përfunduar në kundërshtim me ligjin për marrëdhëniet themelore të punës – si ligj në fuqi në Kosovë – për shkak se AQBK ka mbajtur drejtpërdrejt një takim me parashtruesin e kërkesës të cilit i janë kumtuar bazat për ndërprerjen e marrëdhënies së punës pa dhënë vërejtje paraprake mbi qëllimin dhe bazat e ndërprerjes së marrëdhënies së punës dhe pa iniciuar procedurë disiplinore kundër parashtruesit të kërkesës. AQBK, së këndejmi, ka vepruar në kundërshtim me dispozitat e ligjit në fuqi të sipërpërmendur.
13. Më 6 shtator 2005, Gjykata Komunale në Prishtinë ka vërtetuar vendimin e 26 janarit 2005 e cila është vërtetuar edhe nga Gjykata e Qarkut më 10 qershor 2005 dhe ka refuzuar kërkesën e QBK-së me të cilën është pretenduar se gjykatat në Kosovë nuk kanë autoritet mbi kërkesëpadinë e parashtruesit të kërkesës. Gjykata Komunale e Prishtinës më tutje ka konstatuar se ankesa e AQBK-së e parashtruar në Gjykatën Supreme nuk parandalon ekzekutimin e vendimit më 26 janar 2005.
14. Më 24 janar 2006 Gjykata Supreme ka lejuar kërkesën e AQBK-së për revizion dhe ndryshoi vendimet e Gjykatës Komunale të Prishtinës dhe Gjykatës së Qarkut të Prishtinës në masën ku kërkesëpadia e parashtruesit të kërkesës është refuzuar si e pabazë. Arsyetimi juridik i Gjykatës Supreme bazohet në faktin se njoftimi i cili deklaroi arsyet për përfundim të marrëdhënies së punës ka qenë i mjaftueshëm dhe është në pajtim me Rregulloren e UNMIK-ut (2001/27) e cila zëvendëson tërë legjislacionin i cili nuk është në pajtim me të.

Pretendimet e parashtruesit të kërkesës

15. Parashtruesi i kërkesës pretendon se AQBK-ja nuk e ka kthyer në vendin e punës dhe AQBK-ja nuk i'a ka kompenzuar atij shumën prej 639.60 EUR për të cilën gjë Gjykata Komunale e ka urdhëruar AQBK-në.
16. Parashtruesi i kërkesës pretendon se e drejta e tij juridike për kthim në vendin e tij të mëparshëm të punës është mohuar në mënyrë efektive, për shkak se AQBK-ja nuk ka vepruar në pajtim me aktvendimet e gjykatave më të ulëta e cila përbën shkelje të nenit 49 [E drejta për Punë dhe Ushtrim të Profesionit] dhe nenit 54 [Mbrojtja Gjyqësore e të Drejtave] të Kushtetutës.

"E drejta për punë është e garantuar"

Neni 54 parasheh:

"Çdokush gëzon të drejtën e mbrojtjes gjyqësore në rast të shkeljes ose mohimit të ndonjë të drejte të garantuar me këtë Kushtetutë ose me lig, si dhe të drejtën në mjete efektive ligjore nëse konstatohet se një e drejtë e tillë është shkelur.

Parashtrësirat e palës kundërshtare

17. Në parashtrësirat e saj pranë Gjykatës, AQBK-ja ka deklaruar se parashtruesi i kërkesës nuk është kthyer në vendin e punës për shkak se kërkesëpadia e tij është e papazë dhe juridikisht e paqëndrueshme.
18. AQBK-ja mban qëndrimin se ndërprerja e marrëdhënies së punës së parashtruesit të kërkesës është në pajtim me ligjin në fuqi të Kosovës. Ajo gjithashtu pretendon se në kohën e ndërprerjes së marrëdhënies së punës, AQBK-ja ka ushtruar disa përgjegjësi dhe funksione të cilat kanë qenë nën juridikcionin ekskluziv të Përfaqësuesit Special të Sekretarit të Përgjithshëm që është në pajtim me rregulloret e UNMIK-ut. AQBK-ja mban qëndrimin mëtutje se si rrjedhojë e kësaj veprimet e saj kanë qenë jashtë autoritetit të gjykatave në Kosovë.

Vlerësimi i pranueshmërisë së Kërkesës

19. Me qëllim të gjykimit mbi kërkesën e parashtruesit të kërkesës, gjykata së pari duhet të shqyrtojë nëse parashtruesi i kërkesës ka përmbushur kriteret për pranueshmërinë e rastit e cila parashikohet me Kushtetutë dhe me Rregullore të Punës së Gjykatës.
20. Në lidhje me Kërkesën në fjalë, Gjykata thekson se vendimi i Gjykatës Supreme është marrë më 24 janar 2006, ndërsa Kërkesa i është dorëzuar Gjykatës Kushtetuese më 9 korrik 2009. Kjo do të thotë që Kërkesa ndërlidhet me ngjarjet para 15 qershorit 2008, kur Kushtetuta hyri në fuqi. Si rrjedhojë, Kërkesa është e paafatshme dhe e papajtueshme "ratione temporis" me dispozitat e Kushtetutës dhe Ligjit (*shih Vendimin për papranueshmëri Lënda KI 25/09 Shefqet Haxhiu kundër Organizatës së punës "Industria e akumulatorëve" të datës 21 qershor 2010 dhe Blečić v. Kroacisë Kërkesa Nr. 59532/00, Vendim i GJEDNJ-së i datës 29 korrik 2004*).

Rrjedhimisht, Kërkesa e parashtruesit duhet të refuzohet si e papranueshme .

PËR KËTO ARSYE

21. Në mbështetje të Nenit 20 të Ligjit dhe Nenit 54 (b) të Rregullores së Punës, Gjykata Kushtetuese njëzëri:

VENDOS

- I. TA REFUZOJ kërkesën si të Papranueshme.
- II. Në pajtim me Nenin 20 (4) të Ligjit, ky Vendim do t'iu komunikohet Palëve dhe do të shpallet në Gazetën Zyrtare .
- III. Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtari Raportues

Robert Carolan

Kryetari i Gjykatës Kushtetuese

Prof. Dr. Enver Hasani

Kopje e vërtetuar
Overena kopija
Certified Copy